
ARCHIVAL POST

Protests at the Kavajë Stadium, 1990



Emërtimi i institucionit Prokuroria I
Emërtimi i sektorit Prokuroria

Mod. 7

DOSJE Nr. 639/Viti 1990

TITULLI I DOSJES

Mbi mojaftet e ndodhura në stadiumin e Kavajës, komentet, reagimet, arrestimet dhe masat e marra nga prokuroria e rrethit gjyqësor dhe policia gjyqësore

Afati i ruajtjes i përhershëm
Seria e fletëve 50 - 11

Ka filluar më 2.4.1990
Ka mbaruar më 14.12.1990
Regjistruar në inventarin e dosjeve
me numur rendor

K-237

AIDSSH

SECTION


1970–1991

PERIOD

1990 - 1990

Media 1

MEDIA ITEMS #1



Merre P.OP.Gani Kurti

Dhene b.p." Mekaniku"

T i r s n e ,me 31.3.1990

R A P O R T

Burimi informon se me daten 31.3.1990, qi shkoi me sherbim ne Uzinen e Gozhde - Bullonave ne Kavaje per te diskutuar dhe nxitur prodhimet e kesaj uzine per export. Ne Kavaje burimi u shoqerua me Eduard Rusin, punonjes i Drejtorise se Pergjithneshme Mekanike ne Tirane dhe me drejtorin e tija. Sapo grupi arriti ne Uzine,puntoret ishin mbledhur dhe diskutonin me Kryetarin e Bashkimeve Profesional te qytetit te Kavajes, me drejtuesit e ndermarjes etj. Gjate vizite ne repartin e gozhdeve, u mblodhen rreth nesh, puntoret te cilet shprehnin pakenaqesi te ndryshme. Nder te tjera ata thonin : " A mbahet familja me nje pako gjalpe me muaj; perse behen diferencime midis qytetesh; perse eshte krijuar kjo gjendje ?". Ne takim me Sekretarin e Pare te Durresit ja u kemi ngritur keto probleme,por ai na u mburr se vete ka qene karocier. Ata kerkonin urgjentisht qe te vije dhe te bisedoje gju me gju me ata nje anetar i Byrose Politike, ne te kundert do te nisemi per ne Tirane ".


"Per keto gjendje ekonomike te krijuar, te vije dhe te jap llogari edhe i vdekuri dhe te ngrihet nga varri.

Shoferit te vetures, te Drejtorise Pergjithneshme Mekanike ne mence, puntoret i kishin thene : " I paske mustaqet si te Stalinit. Hape buken qe shoferi kishte marre me vehte, per te pare a e ke me gjalpe dhe kur pane se shoferi kishte vetem buke dhe pak djathe, ju drejtuan perseri duke i thene " qenke dora e jone".

Ne dalje te repartit te gozhdeve, diss puntore thane " a e pate dhe e degjuat zhurmen shurdhuese te makinave te vjetra.Ketu punojme qysh prej 25 vjet dhe nuk jetojme mire" Drejtori i Uzines i tha se " kishte 3 dite pa shkuar ne shtepi, mbasi kishte frike se mos i hidhnin ne ere repartet ".

Burimi, pasi u nda nga Drejtori, i cili shkoi tek Sekre-

MEDIA ITEMS #2



- 2 -

tari i Pare i Rajonit te Kavajes se bashku me Kryetarin e B.Profesio nale.

Ne vazhdim, puntoret i treguan burimit se ne ndeshjen midis "Beses dhe Partizanit" , sambistet e Tiranes, kane rrahur per vdekje 2 puntore te Uzines, dhe neqoftese ndonje prej tyre do te kishte vd kur, puntoret do t'a mernin ne krahe dhe do te marshonin ne drejtim te Tiranes.

Burimi vuri re, se te gjithe puntoret e uzines me te cilet ai bisedoi, ishin shume te indinjuar dhe flisnin pa ndrojtje duke kerkuar bisedime direkte me shoke te Byrose Politike.

Puntoret te mbledhur thane se ne qytetin e tyre jane shkru ar edhe parrulla " Poshte Dinastia, krofte udheheqesi kryesor i Partise " . Gjendja jone ekonomike eshte katandisur keshtu nga Stalini dhe i vdekuri i jone. A keni degjuar shperthime juve te Tiranes.? Burimi rithekaon se puntoret e kesaj Uzine dhe qytetaret e tjere te Kavajes rreth 10 - 15.000 vete, qendrojne te maskuar ne qytet dhe nuk guxon asnjeri qe t'u flase, qofte edhe nje polic, pasi jane gat te ngrihen ne demonstrate.

Zemafilla e ketyre ngjarjeve, sipas puntoreve , nisi ne ndeshjen e futbollit ku u perleshen me sambistet dhe populli kishte ngritur dy gishtat lart ne forme V-je ".

"M E K A N I K U "

V L E R E S I M I : E dhena ka vlere operative,ne te del se puntoret e populli i qytetit te Kavajes eshte shume i revoltuar dhe nuk perjashtohet mundesija qe te ngrihet ne revolte kunder pushtetit.

D E T Y R Ë : Nuk ju dhene per kete gje b.p.

MASAT OPERATIVE: E dhena te shtypet menjehere ne 3 kopje per DPB Durres, nje per Degen e Pare dhe nje per dosjen egjenturore.

Te vihet menjehere ne dijeni drejtuesit ne Drejtori.

Me telegram te njoftohet menjehere DPB Durres dhe Ministri

PUNTORI OPERATIV

G.NI KURTI

INFORMATION


No additional information is available for this media.

TRANSCRIPT

No transcript is available for this media.

Media 2

MEDIA ITEMS #1



REPUBLIKA POPULLORE SOCIALISTE E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
DREJTORIA I
NR. 11623

Sekret
Ekzemplar nr. 1
Tiranë, më 14.12.1990

L ë n d a : Për ngjarjen e ndodhur në qytetin e Kavajës.


SHOKUT: ADIL DHE XHELIL

Dega e Punëve të Brendshme Durrës, na informon se më datën 11.12.1990 rreth orës 17.00 deri në 19.00 u bënë demonstrime në rrugët kryesore të qytetit të Kavajës nga një grup prej rreth 500-600 veta kryesisht elementë armiq e keqbërës. Gjatë demonstrimit jo vetëm që u hodhën parulla të ndryshme fyese, armiqësore, por dhe thyen shumë xhama të vitrinave, të Komitetit të Partisë, komitetit ekzekutiv dhe ndërçuesit e rrugëve kryesore të qytetit.

Fillimisht kjo veprimtari u nis nga 30-40 të rinj, ish të dënuar për krime ordinere, të cilët thërrisnin : "Besa-besë do të fitojmë"; "Kavaja unitet", "Liri-demokraci". Në vazhdim, në qendër të qytetit u grumbulluan mbi 200 veta dhe filluan të hidhnin parulla si : "Poshtë pushteti", "Poshtë Nexhmija", "Poshtë komunizmi", "Enver-Hitler", "Jemi me studentët", "Lironi vëllezërit tanë", "Liri-demokraci" dhe "O Ramiz Alia-dëgjo se ç'thotë rinia" e "Policia vëllezërit tanë". Me këto parulla u demostrua gati për 3 orë.

ADSSH

MEDIA ITEMS #2



2.

Në qendër të qytetit ata dogjën një portret në bezë të Kryetarit të Presidiumit, thyen xhamat e librarisë dhe u futën brënda e grisën disa vepra. Tentuan të përmbysin edhe një autobuz që ndodhej në qendër të cilit i thyen xhamat.

Gjatë demonstrimit kanë qëlluar disa herë me pistoletë dhe kanë hedhur 3 shashka me plasje të forta.

Theksojmë se në datat 8, 9, 10 dhe 11, 12.1990 në disa vende në qytetin e Kavajës u gjetën katër copë fletushka armiqësore, ku bëhej thirrje që të ngrihesh në përkrahje të protestave të studentëve.

Organet tona mbajtën qëndrim korrekt dhe nuk krijuan ndonjë incident.

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME
HEKURAN ISAI

ADSSH

INFORMATION

No additional information is available for this media.

TRANSCRIPT

No transcript is available for this media.